

VENDIM
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane sot ne date 27/05/2003 une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane **Blerina MUCA**, pasi mora ne shqyrtim materialet e paraqitura nga kerkuesi **Z. Adrian RUCI** per rregjistrimin e shoqerise tregetare **R&T ADVERTISING Sh.p.k.**

KONSTATOVA

Se ne date 23/05/2003 eshte vendosur te themelohet Shoqeria tregetare **R&t ADVERTISING Sh.p.k.** me ortake te vetem themelues dhe Administrator **z. Adrian RUCI**, me kapital themeltar **100.000 leke**, kohezgjatje me afat 30 vjet, me seli ne Tirane, Rr. Elbasanit, pall.2, Shk.11, Ap.83. Objekti i veprimtarise do te jete :

- Aktivitet ne fushen e reklames ; ne fushen e botimeve te ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale te tjera publicitare ;
- Konceptim , botim, prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash perfshire ketu edhe ato televizive dhe radiofonike ;
- Shitja , blerja, shkembimi dhe marrja me qira e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme;
- Tregetim , eksport-import i mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, te konfeksioneve, tekstileve, produkteve bujqesore dhe blektorale, fruta perimeve, pajisjeve elektro-shtepiake, hidro-sanitare , elektronike, artikujve kimike, plastike, lekure, materialeve te ndertimit, i mallrave industriale .

PER KETO ARESYE

Meqenese kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligjin 7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne ligjin 7667 date 28/01/1993 "Per rregjistrin tregtar",

VENDOSA


Te rregjistroj Shoqerine Tregtare **R&T ADVERTISING sh.p.k.** me ortake te vetem themelues dhe Administrator **z. Adrian RUCI**, me kapital themeltar **100.000 leke**, kohezgjatje me afat 30 vjet, me seli ne Tirane, Rr. Elbasanit, pall.2, Shk.11, Ap.83. Objekti i veprimtarise do te jete :

- Aktivitet ne fushen e reklames ; ne fushen e botimeve te ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale te tjera publicitare ;
- Konceptim , botim, prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash perfshire ketu edhe ato televizive dhe radiofonike ;
- Shitja , blerja, shkembimi dhe marrja me qira e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme;
- Tregetim , eksport-import i mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, te konfeksioneve, tekstileve, produkteve bujqesore dhe blektorale, fruta perimeve, pajisjeve elektro-shtepiake, hidro-sanitare , elektronike, artikujve kimike, plastike, lekure, materialeve te ndertimit, i mallrave industriale .

Administrator i shoqerise eshte **z. Adrian RUCI** .

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

GJYQTARE
Blerina MUCA



1.

2. a " R & T Advertising" shpk

b. Selia ne Tirane rruga e Elbasanit pallati 2 shk. 11
ap, 83

c. Ne fushen e reklames , te botimeve te ndryshme libra , gazeta
revista, CD dhe materiale tebtjera publicitare.
Tregetim me shumice e pakice import eksport te mallrave
te ndryshme.

Kapitali fillestar 100.000 leke depozituar prane
Bankes Tregetare te Greqise ne Shqiperi date 21.5.2003

Ortak i vetem Ardian Ruci

Administrator Adrian Ruci banues ne Tirane

Akt themelimi 2 flete


Statuti 5 flete

Data e nenshkrimit 26.5.2003

Data e rregjistrimit 27 5.2003

Gjyqtare

Blerina Mucaj



29738



AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR TE EMERUAR "R&T ADVERTISING SH.P.K"

Në Tiranë sot më datë, 29/5/03, unë qytetari:

Adrian Ruci, biri i Thomait lindur në 12 Shtator 1968, banues në Tiranë, me numër letërnjoftimi Nr.NF 481173,

Duke qenë i pranishëm, i deklaruar ortak, vendosa si më poshtë:

1. Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, që më poshtë do të quhet "Shoqëria, me emrin **"R&T Advertising sh.p.k."**, si shoqëri tregtare.

2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- I. aktivitetet në fushën e reklamës; në fushën e botimeve të ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale të tjera publicitare;
- II. konceptim, botim, prodhim, shpërndarje dhe riprodhim reklamash përfshirë këtu edhe ato televizive dhe radiofonike;
- III. shitja, blerja, shkëmbimi dhe marrja me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
- IV. Tregtim, eksport import i mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, të konfeksioneve, tekstileve, produkteve bujqësore dhe blektorale, fruta perimeve, pajisjeve elektro-shtepiake, hidro-sanitare, elektronike, artikujve kimikë, plastikë, lëkure, materialeve të ndërtimit, i mallrave industriale.

3. Selia e shoqërisë është në Tiranë në adresën: Rruga Elbasanit, Pallati 2, Shkalla 11, Apartamenti 83. Shoqëria për ushtrimin e veprimtarisë së saj mund të çelë zyra, filiale ose degë si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin ku do të hapen ato.

4. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë i ndarë në kuota nga 1.000 (njëmijë) lekë secila, gjithsej 100 (njëqind) kuota.

Ky kapital është nënshkruar nga ortaku i vetëm në përmasat e mëposhtme:

- Adrian Thoma Ruci, 100.000 ose 100%

Ky kapital është i gjithi në para, i cili do të derdhet në një nga bankat tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë.

5. Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë me afat 30 vjet.

6. Administrator i shoqërisë është Adrian Ruci, i biri i Thomait, lindur në vitin 1968, dhe banues në Tiranë.

7. Ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar dhe në bazë të statutit të saj dhe këtij akti themelimi.

8. Shoqëria fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumentave të saj themelues dhe bilancin e mbyll me 31 Dhjetor të çdo viti.

9. Ky akt themelimi u hartua dhe u redaktua në prani të ortakut të vetëm dhe shpreh vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

10. Akti i themelimit përpilohet në 4 kopje, me fuqi të barabartë për t'u administruar në organet gjyqësore e tatimore të Tiranës dhe një kopje do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Adrian Thoma Ruci



STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
TE EMERUAR
R&T Advertising sh.p.k.



Neni 1

Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar R&T Advertising sh.p.k., me seli në Rr.Elbasanit,Pallati 2 shkalla 11 Apartamenti 83,Tiranë në përputhje me aktin e themelimit të shoqërisë dhe me legjislacionin Shqiptar në fuqi, rregullon nëpërmjet këtij statuti pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve të kësaj shoqërie.

Neni 2

Shoqëria ka statusin e personit juridik.

Neni3

Shoqëria ka vulën e saj.

Neni 4

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- I. aktivitet në fushën e reklamës, në fushën e botimeve të ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale të tjera publicitare;
- II. konceptim, botim,prodhim,shpërndarjen dhe riprodhim reklamash përfshirë këtu edhe ato televizive dhe radiofonike;
- III. shitja,blerja,shkëmbimi dhe marrja me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
- IV. tregtim,eksport import i mallrave të ndryshme industriale, ushqimore të konfeksioneve, tekstileve, produkteve bujqësore dhe blegtorale, fruta perimeve, pajisje elektro-shtëpiake, hidro-sanitare, elektronike, artikujve kimikë, plastike, lëkure, materialeve të ndërtimit, i mallrave industriale.

Neni 5

Shoqëria do të ketë selinë e saj në qytetin e Tiranës, Shqipëri, Rruga Elbasanit, Pallati 2, shkalla 11, Apartamenti 83. Shoqëria mund të çelë zyra përfaqësimi, degë ose filiale si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin e vendit ku ato do të hapen.

Neni 6

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj me afat 30 vjet.

Neni 7

Kapitali Themeltar i shoqërisë është caktuar në shumën 100.000 (njëqindmijë) lekë i ndarë në kuota nga 1.000 (njëmijë) lekë secila, gjithsej100 (njëqind) kuota.

Ky kapital është i gjithi në para i cili do të derdhet në njërin nga Bankat tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë 100.000 (njqindmije) lekë i ndarë në 100 kuota nga 1.000 (njëmijë) lekë secila, gjithsej 100 (njëqind).

Ky kapital është nënshkruar nga ortakët i vetëm si më poshtë:

-Adrian Thoma Ruci, 100.000 lekë ose 100%.

Ky kapital është i tëri në lekë dhe do të derdhet nga ortakët i vetëm në një nga bankat me seli në territorin e Shqipërisë.

Neni 8

Organi drejtues i shoqërisë është Asambleja e ortakëve dhe organi ekzekutiv është Administratori.

Neni 9

Asambleja e ortakëve është organi vendim-marrës i shoqërisë. Ajo merr vendime që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga organi ekzekutiv i shoqërisë, kur këto vendime nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

Neni 10

Asambleja e ortakëve:

- 1.Miraton rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- 2.Ndryshimin e statutit.
- 3.Emërimin dhe shkarkimin e administratorit të shoqërisë.
- 4.Miratimin e gjendjes financiare të shoqërisë, të bilanceve të saj , librave kontabël dhe për mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë.
- 5.Për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 6.Shqyrtohen ankesat dhe pretendimet e ortakëve ndaj shoqërisë dhe largimin e tyre nga shoqëria.
- 7.Për largimin e përkohshëm të administratorit për shkak sëmundje etj të kësaj natyre si dhe për dhuratat e dhëna të tretëve padrejtësisht.

Neni 11

Administratori i shoqërisë është i detyruar të zbatojë vendimet e asamblese së ortakëve dhe është vetë përgjegjës përpara ortakëve ose personave të tretë në rast se ka vepruar në kundërshtim me vendimet e asamblesë së ortakëve dhe me kompetencat që i jep atij ky statut. Në raste të veçanta caktohet një zëvendës i cili do të veprojë në rolin e administratorit me prokurë të veçantë për një problem të veçantë.



Neni 12

Administratori i shoqërisë ka këto kompetenca:

1. Përfaqësimin juridik të shoqërisë në të gjitha marrëdhëniet e saj me personat e tretë me organet shtetërore shqiptare dhe të huaja me Bankat si dhe me depozitimin e shumave në favor të shoqërisë. Marrja e kredive në emër të shoqërisë kërkon gjithmonë miratimin e ortakëve sipas kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe pajisjen e administratorit me prokurë të posaçme.
2. Përfaqëson shoqërinë përpara organeve gjyqësore të të gjitha shkallëve. Ata kanë të drejtë të caktojnë dhe avokatë me prokurë për shoqërinë për çdo gjë që do të paraqitet.
3. Nënshkruan të gjitha aktet e shoqërisë kundrejt të tretëve dhe që sjellin për shoqërinë të drejta dhe detyrime brenda aktivitetit të shoqërisë.
4. Merr hua dhe kredi me kushte lehtësuese në favor të shoqërisë sipas përcaktimeve që bën asambleja e ortakëve.
5. Është i vetmi person që ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e veprimeve me bankën e kur shoqëria ka llogaritë e saj brenda aktivitetit të shoqërisë dhe vendimeve të marra nga asambleja e ortakëve.
6. Kryen veprime tregtare në emër të shoqërisë si dhe ka të drejtë të marrë dhe japë pasuri me qira në emër të shoqërisë me miratimin paraprak të asamblesë së ortakëve.
7. Lidh dhe zgjidh kontratat e punës me të punësuarit e shoqërisë.
8. Ka të drejtë të bëjë propozime të ndryshme në asamblenë e ortakëve për mbarëvajtjen e punëve, zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë etj.

Neni 13

Administratori i shoqërisë është vetë përgjegjës përpara shoqërisë, të tretëve dhe ligjit për veprimet që ka kryer në emër të shoqërisë por që nuk janë në kompetencë të tyre ose kur nuk kanë qenë të autorizuar nga asambleja e ortakëve për këtë qëllim.

Neni 14

Administratori i shoqërisë nuk mund të kryejë veprime që kalojnë objektin e shoqërisë pa pasur miratim dhe prokurë të posaçme për këto probleme.

Neni 15

Administratori nuk mund të jetë ortak ose aksioner në shoqëri të tjera me të njëjtin objekt veprimtarie me përjashtim të rasteve kur ortakët e shoqërisë i japin zyrtarisht një miratim të tillë.

Neni 16

Administratori përgjigjet vetëm përpara asamblesë së ortakëve.

Neni 17

Administratori duhet të jetë detyrimisht njëri prej ortakëve.



Neni 18

Administratori zgjidhet një herë në vit.

Neni 19

Kuatat e kapitalit të ortakëve janë lirisht të transferueshme të trashgimtarët e ortakëve, dhe për këtë qëllim nuk kërkohet miratimi paraprak i ortakëve. Në rast se ortaku nuk ka trashëgimtare, atëhere kuatat e tij u shpërndahen në mënyrë të barabartë ortakëve të tjerë të shoqërisë.

Neni 20

Viti financiar i shoqërisë fillon me datën 1 Janar dhe mbyllet me 31 dhjetor. Për miratimin e bilanceve të shoqërisë dhe të llogarive të saj veprohet në përputhje me nenin 48 të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 21

Ortakët e shoqërisë gëzojnë gjithnjë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakëve të shoqërisë. Nëse njëri ortak vendos të shesë kuatat e tij të kapitalit duhet t'u ofrojë më parë ortakëve të tjerë duke i njoftuar ata dhe të kërkojë me shkrim mbledhje jashtë rradhe dhe të njoftojë ortakët me letër rekomande. Në rast se ortakët nuk pranojnë t'i blejnë ato duhet që brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve t'i kthejnë përgjigje me letër rekomande ortakut që dëshiron të shesë kuatat e tij. Nëse një njoftim i tillë nuk jepet brenda afatit të parashikuar në këtë nën ortaku ka të drejtë t'ua shesë ato personave të tretë, por në çdo rast gjithnjë jo me një çmim më të ulët se sa i ofruar ortakëve.

Neni 22

Zmadhimi ose zvogëlimi i kuotave nga ortakët bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 23

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të marrin fitimin e realizuar nga shoqëria, pas shlyerjes së tatimeve dhe detyrimeve të tjera ndaj shtetit në përputhje me kuatat dhe përqindjet që ata zotërojnë për krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë. Ndarja e fitimit të shoqërisë dhe mënyra e përdorimit të tij bëhet sipas kuotave për krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 24

Ndryshimet e statutit të shoqërisë bëhen me marrëveshje të ortakëve sipas kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe janë të vlefshme vetëm pasi vendimi të jetë noterizuar dhe regjistruar në gjykatë.

Neni 25

Shoqëria mund të shkrihet ose mund të likuidohet kur për të vendoset me unanimitet nga Asambleja e Ortakëve. Ajo likuidohet edhe me shpalljen e gjendjes së falimentimit nga shoqëria. Me vdekjen e njërit prej ortakëve shoqëria nuk shkrihet ose likuidohet.



Neni 26

Nëse shoqëria gjatë aktivitetit të saj humbet më shumë se $\frac{1}{2}$ (një të dytat) e kapitalit themeltar, duhet të thirret Asambleja e ortakëve për të vendosur shkrijen ose plotësimin e kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast janë të zbatueshme parashikimet e nenit 72 të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 27

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet gjithmonë sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në çdo rast Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për caktimin e likuidatorëve të shoqërisë. Nëse ortakët nuk bien dakort për një gjë të tillë, atëherë likuidatori do të caktohet nga gjykata e cila ka bërë regjistrimin e shoqërisë, për aq kohë sa ligji nuk parashikon ndonjë gjykatë tjetër.

Neni 28

Procedura e likuidimit të shoqërisë do të kryhet sipas procedurës të caktuar në Seksionin e V, nënseksionet I, nenet 264 deri 275 të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 29

Për çdo mosmarrëveshje ndërmjet ortakëve që nuk mund të zgjidhet sipas parashikimeve të këtij statuti, ose në mirëkuptimin ndërmjet tyre, do të jenë kompetencë shqyrtimi dhe zgjidhje nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Bërë në Tiranë në 4 kopje, duke u depozituar pranë noterisë, Gjykatës, Zyrës së Tatimeve, dhe në librin themeltar të shoqërisë.

Tiranë, më 22/5/ 2003

ORTAKU THEMELUES

Adrian Thoma Ruci






KERKESË

2. B. Mucos
27.05.2003
MAG. 2003

KERKUESI Adrian Ruci i biri i Thomait banues me Tirane
i dtl.1968 .



person juridik te shoqerise
"VERTETIM" shpk ne baze te
e 28.1.1993 dhe te ligjit nr.

shkalles se Pare

Tirane

rregjistrimin si person juridik te
shoqerise tregetare "R&A ADVERTISING" shpk me ortak te vetem
z. Adrian Ruci me administrator z. Adrian Ruci me kapital
fillestar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 10 vjet me
se ne Tirane rruga e Elbasanit pallati 2 shk.11 ap. 83.

me objekt te veprimtarise se shoqerise sipas
aktit te themelimit dhe statutit bashkangjitur kerkeses.

Merkoj rregjistrimin si person juridik te kesaj
shoqerie.

Handwritten signature: 461 ref


KERKUESI
ADRIAN THOMA RUCI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 2393 nep

Tirane ,me 26.5.2003

VERTETIM

vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi
per rregjistrimin si person juridik te shoqerisens se mesiperme
u nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesi Adrian Ruci per
indetitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti indetifikues
dhe une noter e vertetoj sipas ligjit.



Noteri
Nezir Murati
Handwritten signature



COMMERCIALBANK OF GREECE (ALBANIA)
BANKATREGTARE E GREQISE (SHQIPERI)

Per: R & T ADVERTISING SHPK

Tirane me, 21/05/2003
Ref.: 116 – OD – 03

VERTETIM

Vertetojme se ne llogarine tuaj **No. 001000200003510** ne **LEK**, te mbajtur me Banken tone eshte depozituar dhe bllokuar nje shume prej **LEK 100,000** (njqind mije) per efekt regjistrimi ne Gjykate.

Ky vertetim leshohet sipas kerkeses tuaj me shkrim.

BANKATREGTARE E GREQISE (SHQIPERI) SH.A.

 Rezart FERZAJ   Mirela BERDUF

To: R & T ADVERTISING SHPK

Tirana on, 21/05/2003
Ref.: 116 – OD – 03

CONFIRMATION

This is to confirm that in your account **No. 001000200003510** in **ALL**, maintained with our Bank, has been deposited and blocked the amount of **ALL 100,000** (one hundred thousand), for Court registration purposes.

This confirmation is issued upon your written request.

COMMERCIALBANK OF GREECE (ALBANIA) S.A.

 Rezart FERZAJ   Mirela BERDUF